

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Hapet thirrja për trajnuesit e Programit “Pas Shkolle”, Kumbaro: Shtrihet në 408 shkolla në të gjithë vendin! – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/hapet-thirrja-per-trajnuesit-e-programit-pas-shkolle-kumbaro-s-htrihet-ne-408-shkolla-ne-te-gjithe-vendin/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 23:35:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	1 shtator 2026, 15:57:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5f241f1d3e1eef87d118bafb10bfcaf67241bd0fc168c5ff8b5600372204acd6
TEKSTI	d3b7e81f05fec552b7167ca0df410307b303669dc2685f6a019fef272e28b0a2
PAMJA	ad7fccfa355cc30ed0411fec6466a8c59b5da9d1768e2e0138b43a946376530e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ec2aa59554168f9ccfb55ecbb0dea23ac9faf9b33e0d7bcd288c1b6e959d6a6f
E MËPARSHMJA	d48b5525e45f25369e41cb3987634ebebe99ca4489a90bea30e021c6cb1f3c58
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ec2aa59554168f9ccfb55ecbb0dea23ac9faf9b33e0d7bcd288c1b6e959d6a6f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Ilustrim · Vizion Plus

Ministrja e Arsimit, Mirela Kumbaro, ka bërë thirrje për mësues, artistë, artizanë dhe profesionistë të fushave të ndryshme që të bëhen pjesë e Programit “Pas Shkolle”, i cili këtë vit do të shtrihet në 408 shkolla në të gjithë Shqipërinë.

Nga shkolla “Andrea Stefani” në Tiranë, Kumbaro bëri me dije risitë e programit për vitin e ri shkollor dhe njoftoi hapjen e thirrjes për trajnuesit që do të angazhohen në zhvillimin e aktiviteteve pas përfundimit të orarit mësimor. Programi synon t’u ofrojë nxënësve mundësi për të mësuar, argëtuar dhe zhvilluar talentet e tyre përmes një sërë aktivitetsesh, ndër të cilat “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, muzikë, teatër, kërcim, zeje, arte pamore dhe sport.

“Këtë vit e shtrijmë Programin ‘Pas Shkolle’ në 408 shkolla të Shqipërisë dhe sot hapim thirrjen për trajnerët e rinj që do të bëjnë të realizueshëm këtë program, i cili kalon nga faza eksperimentale në një shtrirje më të madhe”, u shpreh Kumbaro.

Ministrja Kumbaro theksoi se pjesë e ekipit të trajnuesve nuk do të jenë vetëm mësuesit në detyrë, por edhe mësuesit në pension, mësuesit në listëpritje nga portali, si dhe profesionistë të tjerë që kanë eksperiencë në fushat e parashikuara nga programi.

“Janë jo vetëm mësuesit që mund të marrin pjesë dhe të bëhen pjesë e listës së trajnerëve për Programin ‘Pas Shkolle’, por edhe mësues në pension, mësues që janë në listën e pritjes, madje edhe kolegë të tjerë që

5 Rama uron nisjen e vitit të ri shkollor:
Një vit të mbarë për nxënësit,...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

mund të jenë artistë, artizanë apo profesionistë në fushat që janë parashikuar në programin e ri tashmë të konsoliduar të 'Pas Shkollës'". Në arsimin fillor, programi do të përfshijë edhe mbështetjen për kryerjen e detyrave të shtëpisë, ndërsa aktivitetet e tjera do të fokusohen në artizanat, arte pamore, teatër, muzikë dhe sport", bëri me dije Kumbaro.

Ministrja e Arsimit nënvizoi se "Pas Shkolle" nuk është thjesht një program për të angazhuar fëmijët pas mësimit, por synon të krijojë një hapësirë sociale dhe edukative, duke zhvilluar njëkohësisht komunikimin dhe ndërveprimin social, larg ekraneve dhe teknologjisë.

"Me Programin 'Pas Shkolle' synojmë të krijojmë një hapësirë socializimi dhe zhvillimi, ku nxënësit jo vetëm marrin njohuri, zbulojnë talentet dhe zhvillojnë potencialin e tyre, por kalojnë edhe orë cilësore larg ekraneve. Nuk është thjesht një mënyrë për të mbajtur fëmijët në shkollë dhe për t'i çliruar prindërit nga kujdesi për ta, por është edhe një program social për t'i ndihmuar prindërit. Nëpërmjet këtij programi kombinohen edukimi dhe zbavitja. Janë orë jo vetëm të lira për prindërit, jo vetëm me fëmijët në shkollë dhe të sigurt, por janë orë që i largojnë fëmijët nga ekrani", u shpreh ministrja.

Thirrja për trajnuesit është e hapur pranë zyrave vendore arsimore nga 1 deri më 10 shtator. Të gjithë profesionistët që përmbushin kriteret e përcaktuara mund të aplikojnë për t'u bërë pjesë e ekipit të trajnuesve të Programit "Pas Shkolle", i cili këtë vit do të zbatohet në 408 shkolla në të gjithë vendin.

#Kumbaro

#VizionPlus



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh




SOCIALE

Rama uron nisjen e vitit të ri shkollor: Nj...

Xhuljana Zhuleku

2 orë më parë



SOCIALE

Gjykata e Vlorës i jep fund bojkotit: Nga e...

Taulant Halili

12 Sht



SOCIALE

Stuhi shiu në Elbasan, uji vërshon në rrugë

Taulant Halili

12 Sht



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë

Bota

Vendi

Kronikë

Lifestyle

Programe

Programe

Seriale

Guida TV

Video

Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh

Karriera

Kontakt

Reklamo me ne

Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit

Privatësia

Cookies

Politika editoriale

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.